

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6520  
E enjte, 27 janar 2022  
çmimi 0.40 €

Ambasadori amerikan:  
Diabgu është rruga më e  
mirë për të arritur rezultate



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

DËSHTON TË MIRATOHET REZOLUTA E OPOZITËS KUNDËR  
SHTRENJTIMIT TË RRYMËS

## VETËVENDOSJA NUK E VOTON REZOLUTËN E OPOZITËS KUNDËR SHTRENJTIMIT TË RRYMËS



Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje nuk e kanë përkrahur të mërkurën rezolutën e opozitës kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike. Dështimi i votimit të kësaj rezolute ka bërë që deputetët e PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së ta lëshojnë sallën e Kuvendit. Në një konferencë të përbashkët për medie ata e kanë akuzuar qeverinë dhe shumicën parlamentare që kanë koordinim të plotë me ZRRë-në për rritje të çmimit të energjisë

### AKTUALE



QEVERIA MIRATON PAGESËN  
SHITESË PËR PUNËTORËT  
SHËNDETËSORË F.7

SHOFERI I AUTOBUSIT SHPALLET  
FAJTOR PËR AKSIDENTIN NË  
BULLGARI F.2

ÇEKU: KOSOVA NË TERR PËR  
SHKAK TË POLITIKËS F.7

MBI 4 000 RASTE ME COVID NË 24  
ORËT E FUNDIT NË KOSOVË F.7

### EKONOMI



KOSOVA KA NEVOJË PËR NJË  
SEKTOR DINAMIK PRIVAT F.8

QYTETARËT KUNDËRSHTOJNË  
SHTRENJTIMIN E RRYMËS F.8

### SPORT



AKADEMIA OLIMPIKE E KOK-ut  
BËHET ANËTARE E AKADEMISË  
OLIMPIKE NDËRKOMBËTARE F.10

Qytetarët  
kundërshtojnë  
shtrenjtimin  
e rrymës

FAQE 8



KOSOVA NË SHËRBIM  
TË SHBA-së PËR UKRAINËN

FAQE 4-5

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Shoferi i autobusit shpallet fajtor për aksidentin në Bullgari

**SOFIJE, 26 JANAR** - Shoferi i autobusit është shpallur fajtor për aksidentin e rëndë që ndodhi në Bullgari ku humbën jetën 45 shtetas të Maqedonisë së Veriut me përkatësi etnike shqiptare.

Prokurori bullgar, Borislav Sarafov, ka thënë të martën për agjencinë e lajmeve "Bgnës", se përgjegjës për tragjedinë e rëndë është shoferi i autobusit të agjencisë "Besa Trans". "Shkak i aksidentit është humbja e kontrollit mbi autobusin nga shoferi. Por, edhe shpejtësia e madhe dhe e papërshtatshme, mbi normat e lejuara", ka deklaruar kreu i shërbimit hetimor kombëtar bullgar, Borislav Sarafov. Ai tha se tani vendimi duhet të ekzekutohet nga autoritetet gjyqësore në Maqedoninë e Veriut dhe të njoftohen familjarët e

viktimize, pasi ata kanë të drejtë t'i kontrollojnë materialet.

Aksidenti ndodhi në orët e hershme të 23 nëntorit të vitit 2021, kur autobusi i agjencisë "Besa Trans", i cili po kthehej nga Stambolli, goditi një bankinë në autostradën Struma, pranë fshatit Bosnek, me ç'rast humbën jetën 45 persona, përfshirë edhe shoferin e autobusit, ndërsa shtatë të tjerë pësuan lëndime trupore.

Në mesin e viktimize ishin edhe 12 fëmijë, ndërsa shumica ishin familjarë që kishin udhëtuar në Stamboll të Turqisë për një vizitë treditore.

Hetimet lidhur me rastin kanë nisur edhe në Maqedoninë e Veriut, pasi autoritetet kanë konstatuar se autobusi i aksidentuar nuk kishte leje për transport ndërkombëtar të udhëtarëve.



Dy doganierë janë suspenduar nga puna pasi kishin lejuar autobusin pa leje të kalonte kufirin, agjencisë së udhëtimit i është hequr leja e punës, ndërsa drejtuesi i saj, tani pas raportit të

hetuesisë bullgare mbi shkaqet e aksidentit, mund të përballet dhe me masa të tjera.

Bullgaria është përballur me disa aksidente rrugore vdekjeprurëse edhe në të

kaluarën. Aksidenti i fundit ka ndodhur më 2018, kur 17 turistë bullgarë kishin humbur jetën pas rrëshqitjes dhe rrokullisjes së autobusit si pasojë e lagështisë.

## HRW kërkon hetimin e vrasjeve të protestuesve në Kazakistan



**NJU-JORK, 26 JANAR** - Organizata Human Rights Watch u ka kërkuar autoriteteve të Kazakistanit që hollësisht t'i hetojnë të gjitha të shtënat vdekjeprurëse të civilët nga organet e rendit gjatë

protestave në qytetin Almat. "Ka prova të shumta që tregojnë se forcat e sigurisë hapën zjarr pa ndonjë justifikim të dukshëm dhe vranë të paktën 10 persona. Numri i të vdekurve nga goditja e

dhunshme ka të ngjarë të jetë shumë më i madh dhe kërkon një hetim të shpejtë dhe efektiv", tha Jonathan Pedneault, studiues i konflikteve dhe krizave në HRW, në një deklaratë të lëshuar më 26 janar.

Një protestë paqësore në rajonin perëndimor të Manghystau të shtetit të Azisë Qendrore mbi një rritje të çmimit të karburantit çoi në protesta masive anti-qeveritare në të gjithë vendin dhe përfundoi me të shtëna vdekjeprurëse në Almat.

Gjatë protestave autoritetet kazake ndalën internetin dhe kufizuan funksionimin e telefonisë celulare për pesë ditë.

Presidenti i Kazakistanit, Qasym Zhomart Toqaev, fajësoi aktivistët e

të drejtave dhe gazetarët e pavarur për "nxitjen" e protestave, të cilat çuan në arrestimin e disa reporterëve në qytete të ndryshme anembanë vendit.

Toqaev tha në vazhden e protestave se "20 000 ekstremistë të trajnuar në kampet e huaja terroriste" sulmuan qytetin Almat, por ai nuk dha asnjë provë për ta mbështetur pretendimin.

Me përhapjen e trazirave, Toqaev kërkoi ndihmë nga Organizata e Traktatit të Sigurisë Kolektive (CSTO) e udhëhequr nga Rusia.

Toqaev, gjithashtu, tha publikisht atëherë se ai kishte urdhëruar forcat e sigurisë "të qëllonin për të vranë pa paralajmërim". Autoritetet kazake kanë thënë se 227 persona, përfshirë 19 oficerë të zbatimit të

ligjit, janë vranë në të gjithë vendin, por grupet e të drejtave të njeriut thonë se numri i saktë i njerëzve të vranë gjatë trazirave mund të jetë shumë më i lartë. "Duke pasur parasysh peshën e shkeljeve të supozuara, partnerët ndërkombëtarë të Kazakistanit, duke përfshirë OKB-në, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), anëtare e së cilës është Kazakistani dhe Bashkimin Evropian, duhet të bëjnë presion ndaj Qeverisë së Kazakistanit që të kryejë një hetim efektiv, të pavarur dhe të paanshëm për përgjigjen e forcave të sigurisë ndaj ngjarjeve të janarit, me synimin për të siguruar përgjegjësi të plotë", thuhet në deklaratën e HRW të 26 janarit.

## Përmbyset një anije në Florida, dyshohet për dhjetëra të zhdukur

**TALLAHASSEE, 26 JANAR** - Roja Bregdetare amerikane po kërkon 39 persona që raportohet se janë zhdukur pas përmbysjes së një varke në brigjet e Floridës. Anija dyshohet se ishte përfshirë në aktivitete të kontrabandës me njerëz.

Autoritetet thanë se morën informacion të martën se një person kishte shpëtuar një burrë i cili "po mbahej në një anije të përmbysur rreth 45 milje në lindje të Fort Pierce". I mbijetuari tha se anija ishte nisur nga Bimini në Bahama të shtunën në mbrëmje, por ishte përballur me mot të keq

para se të të përmbysjej. "Sipas të mbijetuarit, asnjë prej personave në bordin e anijes nuk kishte jelek shpëtimi", u tha në deklaratë.

"Ekuipazhet ajrore dhe ekipet e tjera detare të Rojës Bregdetare po kërkojnë në mënyrë aktive për njerëz në ujë. Kjo dyshohet se ishte një sipërmarrje e kontrabandës me qenie njerëzore", shtohet në deklaratën e postuar në "Twitter".

Autoritetet detare thanë se do të vazhdojnë të kërkojnë edhe gjatë natës për personat që konsiderohen të zhdukur. "I mbijetuari i këtij incidenti është



dërguar në spital dhe po trajtohet diellit", ka theksuar roja bregdetare. Kontrabandistët e qenieve

njerëzore përdorin shpesh Bahamën, një grup i ishujve pranë brigjeve të Floridës, si një pikë për të transportuar njerëz, shumica prej të cilëve vijnë nga shtete të tjera të Karaibeve siç është Haiti dhe destinacion kanë Shtetet e Bashkuara.

Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migrim, rreth 5 000 migrantë nga Haiti punojnë ilegalisht në Bahamas, por 20 000 deri në 50 000 e haitianëve qëndrojnë në këtë shtet në mënyrë të jashtëligjshme. Bimini është pika më e afërt e Bahamës me Floridën me një distancë prej 217-kilometrash.

DËSHTON TË MIRATOHET REZOLUTA E OPOZITËS KUNDËR SHTRENJTIMIT TË RRYMËS

# Vetëvendosja nuk e voton rezolutën e opozitës kundër shtrenjtimit të rrymës



Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje nuk e kanë përkrahur të mërkurën rezolutën e opozitës kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike. Dështimi i votimit të kësaj rezolute ka bërë që deputetët e PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së ta lëshojnë sallën e Kuvendit. Në një konferencë të përbashkët për medie ata kanë e akuzuar qeverinë dhe shumicën parlamentare që kanë koordinim të plotë me ZRrE-në për rritje të çmimit të energjisë

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 26 JANAR - Sërish ka dështuar miratimi i rezolutës e cila kishte për qëllim ta parandalonte shtrenjtimin e energjisë elektrike të propozuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE). Rezolutën e opozitës nuk e kanë përkrahur deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, duke mos marrë pjesë në votim.

Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Saranda Bogujevci, ka bërë me dije se në votim kanë marrë pjesë vetëm 30 deputetë. Mospërkrahja e kësaj rezolute nga partia më e madhe në vend ka bërë që deputetët e tri partive opozitare ta lëshojnë sallën e mbledhjes së Kuvendit.

Në një konferencë të përbashkët për medie ata e kanë akuzuar qeverinë dhe shumicën parlamentare që kanë koordinim të plotë me ZRrE-në për rritje të çmimit të energjisë elektrike.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-

së, Abelard Tahiri, ka deklaruar se do të përdorin mekanizma ligjorë për ta kundërshtuar rritjen e paralajmëruar të çmimit të energjisë elektrike. "Sot LV-ja bëri një gjest që tregoi qartë pozicionimin e saj dhe të Kurtit sa i përket ngritjes së çmimeve, pra nuk votuan një rezolutë që do të kërkonte nga ZRrE-ja të mos vazhdojë me një politikë të tillë. Prandaj ne nuk kishim si të vazhdonim më tutje në seancë, që është krejt e parëndësishme në raport me atë që prezantuar ne si grupe parlamentare të opozitës. Duket qartë se parandalim nga qeveria s'do të ketë, sepse ajo është pro rritjes së energjisë elektrike me tarifa dhe norma të papërbalueshme. Duhet që tani të përdorim të gjitha mekanizmat ligjorë për të parandaluar një gjë të tillë", ka thënë Tahiri.

Ai ka theksuar se rritja e energjisë elektrike do të jetë e papërbalueshme për qytetarët e Kosovës. "Sot kemi pritur që një rezolutë e tillë të votohet, pasi

tashmë ka edhe paralajmërimet të ndryshme për protesta e organizime për ta kundërshtuar rritjen e energjisë elektrike, sepse kjo e bën të pamundshme jetën në Kosovë. Paga e një shërbyesi civil, një mjeku, një arsimtari, një polici dhe një punëtori në sektorin privat është e papërbalueshme për ta mbuluar koston e përditshmërisë, duke shtuar këtu edhe çmimin e energjisë elektrike. Kjo mazhorancë tregoi se ka një koordinim të plotë mes ZRrE-së, grupit parlamentar të LV-së dhe qeverisë", ka thënë Tahiri.

Edhe deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka thënë se ngritja e çmimit të energjisë elektrike është një lojë e qeverisë. "Këto improvizime mashtruese janë treguesi më i qartë i mosefikasitetit të kryerjes së detyrës. Veprimet tona janë të ligjshme për mbrojtjen nga e keqja, pra veprimet tona janë në mbrojtje të qytetarëve. Ne nuk mund të bëhemi pjesë e kësaj loje përkundër mbështetjes që

ka nga Lista Serbe", ka deklaruar Zemaj.

Ai ka thënë se veprimet e opozitës për ta parandaluar rritjen e çmimit të energjisë elektrike janë të ligjshme. "Qeveria me mosveprimet e saj e ka sjellë gjendjen këtu. Veprimet tona janë të ligjshme për të parandaluar një të keqe që po i pret qytetarët, pa asnjë mundësi për të kërkuar mundësi të tjera për të përbaluar këtë gjendje e cila është pasqyra e vërtetë e kësaj shumice parlamentare që po vazhdon edhe tash në Kuvendin e Kosovës", ka thënë Zemaj.

Edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se ZRrE-ja dhe qeveria janë në koordinim të plotë për shtrenjtimin e energjisë elektrike. "ZRrE-ja dhe qeveria kanë sinkronizim të plotë në raport me këto tarifa. Vendimi për ngritjen e çmimit është vendim për ta varfëruar qytetarin e Kosovës. Sot polici, mjeku, zyrtari publik, ai në sektorin privat nuk e ka asnjë cent më të madhe pagën, por e ka shumëfish më të lartë çmimin edhe në produkte ushqimore edhe në energji. Albin Kurti populli të ka votuar për të ofruar zgjidhje. Mos ik prej përgjegjësisë. Besimi është i shenjtë. Rreziku i situatës do të

vijë në ditën kur vjen fatura e parë e energjisë elektrike me rritje", ka thënë Tahiri. Sipas tij, rezoluta do ta ndihmonte qeverinë për ta kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike. "Ajo çka pamë sot ishte një abstenim, që nënkupton votim i pavlefshëm që ka ndodhur, të cilin shumë herë e gjykon grupi parlamentar i Vetëvendosjes kur e bëjmë ne si opozitë. Është papërgjegjësi dhe ikje nga besimi qytetar që ky subjekt politik, kjo qeveri, e ka marrë. Mos ikni prej përgjegjësisë", ka thënë Tahiri.

Ndërsa ushtruesja e detyrës e shefes së grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, ka arsyetuar mosbotimin e kësaj rezolute. Ajo ka thënë se rezoluta e opozitës nuk u është shpërndarë deputetëve, prandaj nuk kanë marrë pjesë fare në votim.

Propozimi i ZRrE-së për shtrenjtimin e energjisë elektrike është kundërshtuar nga opozita dhe shoqëria civile. Kjo e fundit të mërkurën ka mbajtur edhe një protestë, duke kërkuar prej qeverisë që të mos lejojë për asnjë cent shtrenjtimin e energjisë elektrike. Ndërsa PSD-ja ka paralajmëruar për të shtunën një protestë gjithëpopullore për ta kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike.



# Kosova në shërbim të ShBA-së për Ukrainën

Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut shprehin mbështetje për Ukrainën në kohën kur tensionet ndërmjet këtij shteti dhe Rosisë kanë arritur kulmin. Vendet perëndimore paralajmërojnë se situata mund të përshkallëzohet shpejt në një sulm të Rosisë kundër Ukrainës, edhe pse Moska e mohon një gjë të tillë

**PRISHTINË, 26 JANAR** - Shteti rus ka javë që ka pozicionuar trupa në kufi me fqinjin e tij, si dhe në gadishullin ukrainas të Krimesë, të cilin e ka aneksuar në vitin 2014. Ministria e Mbrojtjes e Kosovës shpreh gatishmërinë që komponentët e caktuar të Forcës së Sigurisë së Kosovës t'i vendosë në dispozicion të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në rast se kjo i kërkohet për ndonjë mision. Shefi i Komunikimit Strategjik në Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës, kolonel Sefer Isufi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Forca e Sigurisë së Kosovës gjithçka që ka arritur deri më tash - në secilin dimension të zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve të saj operative - e ka arritur falë "mbështetjes së pazëvendësueshme" të ShBA-së. "Duke pasur parasysh që aleanca jonë me ShBA-në është e natyrshme dhe shumë e fuqishme, jemi plotësisht të gatshëm që të jemi përkrah ShBA-së dhe forcave të saj në secilin

mision, ku ata vlerësojnë se mund t'i angazhojnë komponentët tanë profesionalë ushtarakë", thotë Isufi. "Ajo [ShBA-ja] e di më së miri se cilët komponentë të FSK-së mund t'i angazhojë në task-forcën e saj, apo t'i integrojë në kuadër të forcave të NATO-s, në operacionet eventuale në mbrojtje të vlerave euroatlantike gjë që është edhe vizion dhe aspiratë e Kosovës", shton Isufi. Vitin e kaluar Forca e Sigurisë së Kosovës ka qenë për herë të parë pjesë e misionit paqeruajtës ndërkombëtar në Kuvajt, së bashku me trupat amerikane.

## Presidenca: Kosova qëndron përkrah Ukrainës

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka shprehur mbështetjen e Kosovës për Ukrainën përmes një shkrimi në "Twitter". Në një përgjigje me shkrim për "Radion

Evropa e Lirë", Zyra e Presidentes së Kosovës konfirmon se "Republika e Kosovës qëndron përkrah Ukrainës, duke e mbështetur sovranitetin dhe integritetin territorial të saj, pas agresionit të Rosisë të vitit 2014 dhe grumbullimit të forcave ushtarake ruse në afërsi të kufirit të saj me Rusinë". Në përgjigjen e Zyrës së Presidentes së Kosovës thuhet se lëvizjet e fundit ushtarake të Rosisë janë kërcënim jo vetëm për Ukrainën, por edhe për gjithë kontinentin evropian dhe se çdo shkelje e sovranitetit të Ukrainës "paraqet sulm të drejtpërdrejtë ndaj një shteti të pavarur, sulm ndaj demokracisë në kontinentin tonë dhe vazhdimësi të fushatës agresive të Rosisë".

"Ne nuk jemi të vetëm në mbështetje të Ukrainës, por përkrah aleatëve tanë, ShBA-së dhe NATO-s, si dhe me shtetet të cilat dëshirojnë avancimin e vlerave demokratike në

kontinentin tonë dhe në mbarë botën", thuhet në deklaratën e Zyrës së Presidentes së Kosovës.

## Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut përkrahin Ukrainën, Serbia hesht

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë përmes një postimi në "Facebook" më 24 janar, se i bashkohet shqetësimit të partnerëve të NATO-s për rritjen e numrit të trupave dhe mjeteve ushtarake ruse në kufijtë me Ukrainën, duke theksuar se "kërcënimi dhe eventualisht agresioni ushtarak ndaj Ukrainës përbëjnë kërcënim ndaj sigurisë evropiane dhe shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare". "Shqipëria mbështet fuqimisht sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës dhe apelon për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëpërmjet dialogut dhe mjeteve diplomatike", ka shkruar Meta në "Facebook".

Ministria e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, Sllavjanka Petrovska, ka thënë se ky vend mbështet plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të

Ukrainës. Ajo ka thënë se Maqedonia e Veriut, si anëtare e NATO-s, do t'i ndjekë vendimet e aleancës, duke mos përjashtuar përfshirjen në konflikt. "Është e mundur që Ushtria e Maqedonisë së Veriut të përfshihet në një konflikt të mundshëm ushtarak ndërmjet Rosisë dhe Ukrainës, por vetëm nëse këtë e kërkon NATO-ja", ka thënë Petrovska për televizionin maqedonas, Telma, duke theksuar se një veprim i tillë do të ishte i mundur vetëm me pëlqimin e komandantit suprem, përkatësisht presidentit të shtetit, Stevo Pendarovski.

Ambasada e Rosisë në Shkup ka reaguar ndaj deklaratës së ministres Petrovska, duke e cilësuar atë si "befasuese". "Ne u kushtojmë vëmendje deklaratave absolutisht të qarta të udhëheqjes ruse. Rusia kurrë nuk e ka kërcënuar popullin ukrainas askund dhe nuk ka ndër mend të ndërmarrë ndonjë veprim agresiv. Me fjalë të tjera, ne nuk do të sulmojmë, pushtojmë apo godasim Ukrainën. Sa iu përket trupave ruse, ato lëvizin nëpër territorin e tyre dhe kanë çdo të drejtë ta bëjnë këtë", thuhet në reagim.

Presidenti i Kroacisë dhe

komandanti i përgjithshëm i Forcave të Armatosura të këtij vendi, Zoran Millanović, ka njoftuar se do ta tërheqë ushtrinë kroate nëse situata në Ukrainë përshkallëzohet. Ushtria kroate ndodhet aktualisht në kufirin rus me një operacion të NATO-s.

Vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnjë e Hercegovina, deri më tash nuk kanë reaguar për tensionet midis Rusisë dhe Ukrainës. Mali i Zi, ashtu sikurse Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia e Veriut, është anëtar i NATO-s.

### Rashiti: Konflikti që do ta ndryshojë arkitekturën e sigurisë në Evropë

Naim Rashiti, drejtor i Grupit të Ballkanit për Politika, me bazë në Prishtinë, thotë se përplasjet Rusi-Ukrainë do të ishin konflikti më i madh që pas Luftës së Dytë Botërore, pas krizës së Kubës dhe pas rënies së Murit të Berlinit. Ai shton se ky është konflikti më i

madh dhe më i hapur ndërmjet ShBA-së dhe Rusisë. Rrëhimin e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut përkrah Ukrainës ai e sheh si veprim të drejtë. “Një konflikt i tillë do ta ndryshojë tërë dinamikën gjeopolitike globale. Me theks të veçantë, do ta ndryshojë arkitekturën e sigurisë së Evropës dhe të Bashkimit Evropian. Prandaj, është shumë e drejtë që të rreshtohen drejt mbështetjes së vendeve sovraane, pengimit të pushtimit dhe okupimit me dhunë, fushatave kundër tyre, si dhe në mbështetje të një plani tashmë shumëvjeçar transatlantik për ta ruajtur sigurinë e Evropës”, thotë Rashiti për “Radion Evropa e Lirë”. Ai shton se situata e tanishme shpërfaq edhe dobësinë e Evropës, e cila, sipas tij, nuk po tregohet e gatshme që të ndërtojë arkitekturë të sigurisë për vetveten dhe ShBA-ja mbetet garantuesja kryesore.

Tensionet ndërmjet Rusisë dhe Ukrainës mund të pasohen me dy skenarë, të cilët do të reflektohen edhe në rajonin e Ballkanit

Perëndimor, vlerëson Naim Rashiti nga Grupi i Ballkanit për Politika. Ai thotë se skenari i parë dhe më i butë që mund të pasojë, parasheh që Rusia të krijojë dhe mirëmbajë një regjim pro-rus në Ukrainë, i cili do ta pengonte shtrirjen e politikave të Perëndimit.

Në të njëjtën mënyrë, sipas tij, Rusia do të provojë t'i mirëmbajë edhe elementet pro-ruse që janë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë skenar, siç shpreh mendimin Rashiti, nuk do të ketë reagim të Perëndimit ndaj situatës së zhvilluar në Ukrainë dhe kjo do ta trimërojë Moskën që të vazhdojë dhe t'i përforcojë skenarët e ngjashëm në Ballkanin Perëndimor, në veçanti në Serbi, në Bosnjë e Hercegovinë, në Mal të Zi, por edhe në Maqedoninë e Veriut.

Skenari i dytë dhe më i vështirë, shton ai, është pushtimi dhe okupimi rus i Ukrainës. Në këtë skenar, vlerëson Rashiti, Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja pritet të shfaqin dilemën se a do ta ruajnë Ballkanin Perëndimor nga

ndikimi rus, a do ta shkëpusin atë nga ky ndikim apo do ta ruajnë status quo-në.

Siç thotë Rashiti, në rast se Rusia do t'i qaset pushtimit të Ukrainës, atëherë Ballkani Perëndimor nuk do të mund t'i shmanget efektit eventual të këtij zhvillimi.

Presidenti i SHBA-së, Joe Biden, ka zhvilluar të hënën një video-konferencë me aleatët evropianë për krizën në Ukrainë, pas së cilës ka thënë se në mesin e tyre ekziston “unanimitet i plotë”.

Mbretëria e Bashkuar e ka paralajmëruar Rusinë për sanksione “të shpejta” dhe “të pashembullta” nëse ndodh inkursioni rus në Ukrainë. Kësaj deklarate i janë bashkuar Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania, Italia, Polonia dhe vende të tjera. Ministrat e jashtëm të Bashkimit Evropian janë pajtuar në një takim të hënën se “çdo agresion i mëtejshëm ushtarak nga Rusia kundër Ukrainës, do të ketë pasojë masive dhe kosto të rëndë”, thuhet në një deklaratë të përbashkët të tyre.

Pentagoni ka njoftuar tashmë se

rreth 8 500 trupa amerikane janë në gatishmëri të lartë për dislokim. Por, kjo do të ndodhë vetëm nëse aleanca ushtarake e NATO-s vendos ta aktivizojë forcën e reagimit të shpejtë, “ose nëse zhvillohen situata të tjera” në lidhje me grumbullimin e trupave ruse, ka thënë zëdhënësi i Pentagonit, John Kirby.

ShBA-ja nuk ka plane për t'u vendosur në Ukrainë, ka theksuar ai.

NATO dhe Shtetet e Bashkuara kanë thënë se janë duke përgatitur një dokument për t'i adresuar shqetësimet e Rusisë për sigurinë në Evropë.

Edhe pse mohon synimet për pushtim, Moskë e akuzon Kievin se po përgatit sulme në zonat që kontrollojnë separatistët pro-rusë në lindje të Ukrainës dhe thotë se vendet e NATO-s po e “pompojnë” Ukrainën me armë.

Rusia, po ashtu, kërkon që NATO-ja të mos e pranojë kurrë Ukrainën në radhët e saj dhe të tërheqë një pjesë të konsiderueshme të forcave nga Evropa Lindore.



## NATO-ja bën gati anijet dhe avionët luftarakë për Rusinë

Aleanca e NATO-s, tashmë së bashku me aleatët e saj, janë në gatishmëri dhe po dërgojnë anije dhe avionë luftarakë shtesë në Evropën Lindore, duke përforcuar mbrojtjen e Ukrainës përballë rrethimit ushtarak nga Rusia.

Me anë të një njoftimi, NATO ka bërë me dije se disa vende aleate të saj kanë bërë të ditura

dërgesat aktuale ose të ardhshme.

Danimarka është një nga disa shtetet ku në Detin Baltik do të dërgojë një anije luftarake dhe katër avionë luftarakë F-16 në Lituani në mbështetje të misionit afatgjatë ajror të NATO-s.

Spanja, gjithashtu, ka nisur anije për t'u bashkuar me forcat

detare të NATO-s dhe po shqyrton dërgimin e avionëve luftarakë në Bullgari. Ndërsa, Franca ka shprehur gatishmërinë e saj për të dërguar trupa në Rumani nën komandën e NATO-s. Kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë duke e shqyrtuar rritjen e pranisë ushtarake në pjesën lindore, ndërsa Holanda

ka bërë gati dy avionë luftarakë F-35 në Bullgari dhe po vendos një anije dhe njësi me bazë tokësore në gatishmëri për NATO-n.

Në lidhje me këtë ka reaguar edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, i cili ka thënë se i mirëpret aleatët që kontribuojnë me forcat e tyre në NATO. “NATO-ja do të

vazhdojë të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur të gjithë aleatët, duke përfshirë edhe përforsimin e pjesës lindore të Aleancës. Ne gjithmonë do t'i përgjigemi çdo përkeqësimi të mjedisit tonë të sigurisë, duke përfshirë forcimin e mbrojtjes sonë kolektive”, ka thënë Stoltenbergu.

## Konjufca infektohet me Covid

PRISHTINË, 26 JANAR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Për

gjendjen e tij ka njoftuar nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujvci, në seancën e së mërkurës, në të cilën po

shqyrtoheshin pikat e papërfunduara të seancave të kaluara. "Kryetari ka rezultuar pozitiv me Covid-19, kështu

që nuk mund të marrë pjesë në seancë. Shpresoj që do ta kalojë shumë shpejt dhe me lehtësi", ka thënë Bogujvci.



## Ambasadori amerikan: Dialogu është rruga më e mirë për të arritur rezultate

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 JANAR - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, ka konfirmuar se javën tjetër në Prishtinë do të qëndrojë për vizitë emisari special amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Ambasadori Hovenier përmes një postimi në "Twitter" ka shkruar se dialogu mbetet mënyra e vetme që Kosova të japë rezultate për qytetarët e saj. "Unë dhe ekipi im mezi presim që përfaqësuesi special Escobar të vijë në Kosovë javën e ardhshme. Progresi në dialogun e lehtësuar nga BE-ja mbetet mënyra më e mirë për të siguruar që liderët kosovarë mund të japin rezultate për qytetarët dhe që Kosova të njihet dhe të zë vendin e merituar si lidere botërore", ka shkruar Hovenier. Edhe Departamenti i Shtetit amerikan, Byroja e Çështjeve

Evropiane dhe Euroaziatike, ka njoftuar i dërguari special i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, do ta vizitojë Prishtinën javën e ardhshme së bashku me të dërguarin special të BE-së, Miroslav Lajçak, për ta shtyrë përpara çështjen e normalizimit të raporteve në të mes Kosovës dhe Serbisë. "I dërguari amerikan, Gabriel Escobar, do t'i bashkohet të dërguarit special Miroslav Lajçakut në Bruksel, Prishtinë dhe Beograd, nga 30 janari deri më 4 shkurt, për t'i inkurajuar liderët e Kosovës dhe të Serbisë për t'i normalizuar marrëdhëniet", thuhet në njoftimin për media. Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011. Raundi i fundit i dialogut në nivel të lartë, ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, është mbajtur në korrik të vitit 2021.



## Nis testimi i nxënësve të Kamenicës kundër virusit Covid



KAMENICË, 26 JANAR (ER) - Ekipi mobil për testim kundër virusit Covid-19 në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit në Kamenicë kanë nisur testimin e nxënësve nëpër shkolla. Testimi ka filluar me nxënësit e shkollës "Metush Krasniqi" në Roganë. Gjatë testimit i pranishëm ishte u. d. i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, Visar Dërmaku, dhe u. d. i drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Rifat Hajdari, si dhe drejtori i shkollës Florim Kryeziu. Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka thënë se testimi i nxënësve do të bëhet në të gjitha shkollat në mënyrë që t'i identifikojnë rastet me Covid-19. "Sot ka filluar testimi i nxënësve

nga ekipet mobilie mjekësore të formuara kundër Covid-19. Testimi ka filluar me nxënësit e shkollës 'Metush Krasniqi', por do të vazhdojë edhe në shkollat e tjera. Qëllimi ynë është që t'i identifikojmë nxënësit e prekur nga ky virus në mënyrë që ta rishikojmë vazhdimin e mësimin sipas udhëzimeve të IKShKP-së dhe nxënësit të mos mbesin mbrapa me mësimin", ka thënë ai. Edhe u. d. i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, Visar Dërmaku, ka thënë se pas rezultateve të këtyre testeve, do të vendoset se si do të vazhdojë procesi mësimor sipas rekomandimeve të IKShKP-së. Testimi i nxënësve do të vazhdojë edhe në shkollat e tjera të Kamenicës në ditët në vazhdim.

## Një shtetas i Kosovës dënohet për terrorizëm

PRISHTINË, 26 JANAR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka njoftuar se ka shqiptuar dënimin prej dy vjet e tetë muaj ndaj një personi për akuza që lidhen me terrorizmin. Gjykata njoftoi se i akuzuar K. D u dënua për veprën penale "Organizim dhe pjesëmarrje në grup terrorist". Ky institucion nuk dha detaje se cilit grup i ishte bashkuar i akuzuari apo për periudhën kohore kur e ka

bërë këtë veprë penale. Dënimin ai do ta vuajë 15 ditë pasi të bëhet i plotfuqishëm ky aktgjykim, "ndërsa koha e kaluar në paraburgim nga data 17 korrik 2021 e tutje, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar". Por, deri në plotfuqishmërinë e vendit, i akuzuari do të qëndrojë në paraburgim. Palët kanë të drejtë që të paraqesin ankesë në

Gjykatën e Apelit lidhur me këtë aktgjykim. Në vitin 2015 Kosova miratoi një ligj të posaçëm që sanksionon pjesëmarrjen në luftëra të huaja, ku parashihen dënime deri në 15 vjet burgim. Kosova, me ndihmën e Shteteve të Bashkuara, në prill të vitit 2019 ka rikthyer mbi 100 shtetas të saj, kryesisht gra dhe fëmijë, që kishin qenë në zonat e konfliktit në Siri.



# Qeveria miraton pagesën shtesë për punëtorët shëndetësorë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 JANAR - Qeveria e Kosovës ka miratuar ndarjen e pagesës shtesë prej 10-përqindësh të pagës bazë për punëtorët shëndetësorë jo më pak se 60 euro. Gjatë mbledhjes së qeverisë, që u mbajt të mërkurën, u tha se kjo pagesë do të bëhet për periudhën janar - qershor 2022.

Ndarja e shtesave për punëtorët shëndetësorë kishte nisur vitin e kaluar.

Gjatë mbledhjes kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se vendi po përballlet me një valë të shkaktuar nga varianti Omicron i Covid-19. Teksa kujtoi se një ditë më parë Kosova regjistroi 2 707 raste me Covid-19, ai ka thënë se gjendja me pandeminë “është e rënduar”. “Numër kaq të lartë të rasteve në ditë nuk kemi pasur që nga muaji gusht i vitit të kaluar kur e kishim situatën shëndetësore shumë të rënduar. Madje janë tejkaluar shifrat e gushtit. Gjendja është e rënduar edhe tani. Kjo rritje e shpejtë e

rasteve rrit numrin e spitalizimeve dhe ngarkesën mbi sistemin tonë shëndetësor e mund të rezultojë në më shumë vdekje. Ne po na duhet të kujdesemi si për shëndetin e popullsisë, ashtu edhe për kapacitetet e shëndetësisë”, ka thënë Kurti.

Të shtunën, më 22 janar, Kosova regjistroi 3 206 raste, që është shifër rekord e infektiveve ditore që prej fillimit të pandemisë. Kurti u bëri thirrje qytetarëve që të vaksinohen kundër koronavirusit dhe t'i respektojnë masat.

Në Kosovë më 22 janar kanë hyrë në fuqi masat e reja kundër pandemisë, ku parashihet kufizimi i lëvizjes nga ora 22:00 deri në orën 05:00. Po ashtu, sipas masave të reja, çdo person që hyn në Kosovë duhet ta paraqesë dëshminë e vaksinimit me tri doza të vaksinës ose me dy doza dhe test negativ PCR.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se varianti Omicron po vazhdon të përhapet me intensitet të lartë dhe është varianti dominues në



qarkullim që po rëndon gjithnjë e më tepër situatën epidemiologjike. “Virusi është kudo andaj mos neglizhoni rekomandimet themelore: maskën, distancën, higjienën. Shmangni udhëtimet, qëndroni në shtëpi dhe ajrosni ambientet e mbyllura. IKShPK-ja është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje e shijes, rekomandohen të testohen. Situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë ditët në vazhdim, andaj IKShPK apelon te të gjithë qytetarët që të respektohen masat e qeverisë”, ka njoftuar IKShPK-ja. Ky institut ka njoftuar se Omicron është tejet ngjitës, andaj ka bërë

## Mbi 4 000 raste me Covid në 24 orët e fundit në Kosovë

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se nga 16 307 testime, 4 397 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk janë shënuar raste të vdekjes. Të mërkurën janë shënuar 607 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shënuarve është 162 333. Në total numri i rasteve aktive është 25 458. Ministria e Shëndetësisë në 24

orët e fundit ka njoftuar se janë dhënë 5 459 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 759 797 doza të vaksinës. Deri më sot 832 020 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 65 147 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.

thirrje që të mbahen maskat në çdo vend. “Duke qenë se vaksinimi është mënyra më e mirë dhe më e sigurt për ta parandaluar Covid-19, veçanërisht format e rënda të sëmundjes dhe vdekjet,


ne vazhdojmë të apelojmë fuqishëm për vaksinim sa më gjithëpërfshirës, sa më të gjerë dhe sa më të shpejtë të popullatës nga mosha 12-vjeçare”, ka njoftuar IKShPK-ja.



## Çeku: Kosova në terr për shkak të politikës

PRISHTINË, 26 JANAR - Rehabilitimi i pesë blloqeve të termocentralit “Kosova A” mund ta nxjerrë Kosovën nga terri, thotë në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, ish-ministri i Energjisë, Ethem Çeku.

Për krizën energjetike me të cilën po përballlet Kosova, Çeku fajëson politikën. Sipas tij, sektori i energjisë kërkon një konsensus politik. Pa një konsensus të tillë ai thotë se Kosova do të mbetet me linjit të bollshëm e të politizuar, pa ndërtimin e termocentraleve të reja dhe do të përballlet me reduktime të ashpra të energjisë. Kosova, sipas tij, këtë krizë energjetike nuk do ta kishte sigur ta zhvillonte projektin e Termocentralit “Kosova e Re”. “Kosova ka 11 miliardë tonë linjit që ka mundur t'i fusë në përdorim, në zhvillimin e sektorit të energjisë.



Fatkeqësisht, politikat e gabuara që janë bërë, kanë lënë 11 tonë linjit të papërdorshëm. Sot Kosova, si një nga vendet më të pasura në botë në fushën e linjtit, duhet të blejë energji

elektrike nga 500 euro për megavat, derisa kemi mundur të prodhojmë me 56-60 euro megavat. Këto janë politikat e gabuara që janë bërë nga qeveritë të cilat nuk e kanë lejuar

zhvillimin e projektit të termocentralit ‘Kosova C’, dhe duke larguar katër konsorciumet e mëdha botërore të asaj kohe, të cilat kishin konkurruar për ndërtimin e blloqeve për

ndërtimin e termocentralit ‘Kosova C’, që më vonë e ndërruan emrin dhe e bënë ‘Kosova e Re’. Po ashtu, e ndërruan edhe projektin në tërësi dhe kjo bëri që të largohen nga Kosova investitorët që ishin të fuqishëm”, ka thënë ai, duke shtuar se Kosova humbi rastin që të ndërtojë termocentrale të reja, që në atë kohë kishin mbështetje edhe të Bankës Botërore dhe Komisionit Evropian. “Banka Botërore ndau fonde, u dhanë garanci bankare për zhvillimin e sektorit të energjisë. Vendet e Bashkimit Evropian mbështetën zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë. USAID-i bëri një punë të madhe, dërgoi ekspertët më të mirë të fushës së energjisë dhe u bë një ekip i jashtëzakonshëm për ndërtimin e termocentralit, por termocentrali nuk u ndërtua”, ka theksuar Çeku.

# Kosova ka nevojë për një sektor dinamik privat

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 20 JANAR** - Fuqizimi dhe thellimi i lidhjeve ekonomike dhe marrëdhënieve tregtare, i cili do të rezultojë në prosperitet më të madh për amerikanë dhe kosovarë, është në mesin e prioriteteve më të larta për ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeff Hovenier. Duke folur në mbledhjen vjetore të Kuvendit të Përgjithshëm të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, ambasadori Hovenier ka theksuar se viti 2021 ishte vit i mirë për ekonominë e Kosovës dhe që sektori privat është nxitësi kryesor i rritjes ekonomike.

Ai ka theksuar rëndësinë e një sektori dinamik privat si dhe nevojën e fuqizimit të dialogut me komunitetin e biznesit, dhe shfrytëzimin e fuqisë së investimeve nga diaspora. "Një ndër prioritetet kryesore të Ambasadës sonë është përkrahja e trajektoreve evropiane dhe euroatlantike të Kosovës. Kosova është treg i vogël, por ka potencialin të shndërrohet në një qendër të

tregtisë dhe investimeve në Evropën juglindore", është shprehur ambasadori Hovenier, duke shtuar se Ambasada e Shteteve të Bashkuara përkrah iniciativat që krijojnë tregti më efikase ndërkufitare dhe që çojnë në një ekonomi më konkurruese dhe më përfshirëse për Kosovën.

Veç kësaj, ambasadori amerikan ka pohuar se derisa sektori publik ka fuqi të arrijë shumë synime, është me rëndësi të largohet nga sektorë të caktuar të ekonomisë, për ta lënë sektorin privat të bëjë më të mirën.

Në fund, ambasadori Hovenier u bëri thirrje kompanive në Kosovë të promovojnë dhe zbatojnë masat parandaluese si maskën e fytyrës, distancën sociale dhe vaksinimin brenda stafit dhe klientëve të tyre, derisa varianti Omicron vije të jetë i pranishëm dhe po shpërndahet me shpejtësi në Kosovë.

Presidenti në largim i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, Ilir Ibrahim, ka shprehur mirënjohjen për të gjithë anëtarët, Ambasadën e



ShBA-së si dhe drejtorin ekzekutiv dhe ekipin e tij për përkrahjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin përgjatë viteve.

Ibrahim ka thënë se, pavarësisht prej ndryshimeve të shpeshta në qeveri, Oda Amerikane ka qëndruar fuqishëm në qëndrimet e saj, duke ofruar të jetë partnere e secilës qeveri, pa bërë kompromise në avokimin dhe mbrojtjen e anëtarëve të saj. Ai ka thënë se me 210 anëtarët e saj Oda Amerikane me krenari gëzon reputacionin e një asociacioni profesional dhe të

fuqishëm të biznesit.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë se përgjatë dekadës së fundit organizata është rritur gati tri herë për kah anëtarësia, financat dhe stafi, duke shtuar se sa më e fuqishme që organizata është bërë përgjatë viteve, aq më shumë e ka kuptuar që duhet t'u qëndrojë besnike vlerave dhe parimeve të Odës Ekonomike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Uashington, si dhe vlerave individuale që çdokush në Odën Amerikane përfaqëson.

Ai ka falënderuar anëtarët në largim të stafit për udhërrëfimin dhe mbikëqyrjen e tyre, Ambasadën e ShBA-së për përkrahjen e tyre dhe institucionet e Kosovës për partneritetin e tyre.

Delegatët e Kuvendit të Përgjithshëm të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë zgjedhën Bordin e ri të Guvernatorëve, ndërsa për herë të parë përgjatë ekzistencës tetëmbëdhjetëvjeçare të organizatës, Afronë Rudi nga Deloitte është zgjedhur si presidentja e parë grua e Bordit të Guvernatorëve.

## Qytetarët kundërshtojnë shtrenjtimin e rrymës

**PRISHTINË, 26 JANAR** - Një grup qytetarësh në Prishtinë protestuan të mërkurën kundër propozimit për shtrenjtim të çmimit të energjisë elektrike. Duke mbajtur pllakate në duar, në të cilat shkruhej "Asnjë cent më shumë", qytetarët marshuan në sheshet kryesore dhe u ndalën para ndërtesës së qeverisë. Aty kundërshtuan propozimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) për tarifën e reja të energjisë.

Protestuesit thanë se propozimi për shtrenjtimin e rrymës është i padrejtë, pasi ata veçse po përballeshin me krizën ekonomike dhe atë të pandemisë. "Propozimi i fundit i ZRRë-së për vendosjen e bllok-tarifave dhe rritjen e çmimit të energjisë do të na varfërojë edhe më tej secilin prej nesh. Ky propozim thellësisht i padrejtë dhe zhvatës është një tentativë tjetër për të na faturuar ne qytetarëve pasurimin e bizneseve", tha një prej organizatoreve të protestës.

Në Kosovë është paralajmëruar rritja e çmimit të rrymës pasi, siç ka thënë qeveria, vendi po blen rrymë me çmime të larta dhe nuk po mund ta plotësojë kërkesën me prodhimin e

rrymës në termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B". Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) ka propozuar rritje të çmimeve të energjisë për amvisëritë, por jo për bizneset. Qeveria ka thënë se ka ndarë 75 milionë euro që të subvencionojë një pjesë të faturave të energjisë.

### Sa pritet të jenë faturat e energjisë?

Në propozimin e ZRRë-së për shtrenjtimin e rrymës konsumatorët janë ndarë në pesë kategori: A, B, C, D, E. Nëse jeni në kategorinë A, pra nëse gjatë një muaji shpenzoni 300 kilovatë orë energji elektrike, atëherë çmimi aktual i faturës suaj është 18.87 euro. ZRRë-ja ka propozuar që kjo faturë të rritet në 20.40 euro. Por, me subvencionim nga Qeveria, fatura juaj do të mbetet e njëjtë: 18.87 euro.

Nëse jeni në kategorinë B, apo gjatë një muaji shpenzoni 450 kilovatë, atëherë çmimi aktual i faturës suaj është 27.37 euro. ZRRë-ja ka propozuar që kjo faturë të rritet në 29.66 euro. Por, me subvencionim nga Qeveria, fatura juaj do të mbetet e njëjtë: 27.37 euro.

Nëse jeni në kategorinë C, që do



të thotë se për një muaj shpenzoni 600 kilovatë, atëherë çmimi aktual i faturës suaj është 35.86 euro. ZRRë-ja ka propozuar që kjo faturë të rritet në 38.92 euro. Por, me subvencionim nga Qeveria, fatura juaj mbetet e njëjtë: 35.86 euro.

Nëse jeni në kategorinë D, pra nëse gjatë muajit shpenzoni 800 kilovatë, atëherë çmimi aktual i faturës suaj është 47.19 euro. ZRRë-ja ka propozuar që kjo faturë të rritet në 74.17 euro. Por, me subvencionim nga Qeveria, fatura juaj do të jetë: 59.50 euro.

Nëse jeni në kategorinë E, që do të thotë se gjatë muajit shpenzoni 1000 kilovatë, atëherë çmimi aktual i faturës suaj është 58.52 euro. ZRRë-ja ka propozuar që kjo faturë të rritet në 109.42 euro. Por, me subvencionim nga Qeveria, fatura juaj do të jetë: 83.14 euro.



# Si i mbajti Tito jugosllavët së bashku në një shtet federativ?

Nga Aleksa DJILAS

Kur presidenti i Jugosllavisë, Marshalli Tito, vdiq më 4 maj 1980, përfaqësuesit e 122 shteteve, duke përfshirë një grup mbresëlënës liderësh botërorë, morën pjesë në funeralin e tij. Ai u nderua si lideri i fundit i madh i Luftës së Dytë Botërore, si komunisti i parë që sfidoi me sukses Stalinin, dhe si themeluesi i "komunizmit kombëtar".

Mbi të gjitha, Tito u vlerësua si krijuesi i Jugosllavisë moderne, liderishipi, mençuria dhe mjeshtëria e të cilët, bashkoi në një federatë të qëndrueshme popujt historikisht antagonistë të Jugosllavisë. Në librin e tij të shkëlqyer "Tito: Ngritja dhe rënia e Jugosllavisë", Riçard Uest na ofron një biografi, udhëtime dhe histori popullore të Jugosllavisë, dhe një analizë të personaliteteve dhe ngjarjeve që sollën shpërbërjen e vendit dhe luftën civile.

Tito si unifikues i Jugosllavisë, është një nga temat kryesore të autorit. Partia Komuniste erdhi në pushtet në Jugosllavi në fundin e Luftës së Dytë Botërore, pasi ushtria e saj partizane luftoi jo vetëm kundër pushtuesve gjermanë dhe italianë, por edhe ndaj jugosllavëve të tjerë në njësitë ushtarake rivale, shpesh tradhtarë.

Partizanët ishin një formacion ushtarak shumëkombësh (edhe pse serbët dominuan në gjysmën e parë të luftës), ashtu siç ishte edhe Partia Komuniste. Në propagandën e tyre, ata flisnin për barazinë midis kombeve në një Jugosllavi federale. Kjo gjë i ndihmoi ta fitonin luftën civile, pasi kundërshtarët e tyre ishin kryesisht nacionalistë me ndjekës vetëm brenda grupeve të tyre kombëtare, dhe ekstremizmi i të cilëve distancoi segmente të mëdha të popullsisë.

Pas luftës dhe gjatë gjithë Luftës së Ftohtë, një Parti Komuniste triumfuese me Titon në krye, pretendoi se e kishte zgjidhur një herë e mirë problemin e kombësive. Për shkak se Jugosllavia u shemb pas vdekjes së Titos, shumë njerëz madje edhe në Perëndim, besojnë se ai ishte gjenialiteti i tij që e mbajti atë të bashkuar.

Por asgjë nuk mund të jetë më larg të vërtetës sesa kjo gjë. Josip Broz "Tito" lindi në vitin 1892 në Kroaci, asokohe pjesë e Austro-Hungarisë. Babai i tij ishte kroat, nëna e tij slovene, dhe ata ishin ndër familja më e pasur në fshatin e tyre.

Në moshën 15-vjeçare, Tito u largua nga shtëpia dhe duke ndërruar shpesh punë, endej

nëpër qytetet industriale të Evropës Qendrore. Si ndihmës i ri i një bravandreqësi, Tito kishte njëfarë simpatie për lëvizjen socialdemokrate, por nuk ishte politikisht aktiv.

Ai nuk u përfshi as me lëvizjen e kroatëve të rinj revolucionarë dhe serbëve të Austro-Hungarisë, që synonin shpërbërjen e monarkisë së Habsburgëve dhe bashkimin e territoreve të tyre me Serbinë dhe Malin e Zi për të formuar një shtet të ri, Jugosllavinë (që do të thotë "toka e sllavëve të jugut"). Kur Austro-Hungaria sulmoi Serbinë në vitin 1914, Tito u dërgua si rreshter në frontin serb. Nacionalistët e sotëm serbë, e interpretojnë këtë si një shenjë të qëndrimit të tij të hershëm anti-serb. Por shumë kroatë dhe serbë të tjerë luftuan besnikërisht për monarkinë në të gjitha frontet e saj të Luftës së Parë Botërore.

I transferuar në frontin rus, Tito u plagos dhe u kap rob. Pas shërimit, u arratis në vitin 1917 në Petrograd (Shën Petersburg), por nuk mori pjesë në Revolucionin e Tetorit. Ai mendoi të emigronte në Shtetet e Bashkuara, por peripecitë e fatit e çuan në Omsk të Siberisë, ku bolshevikët ishin në pushtet. Ai u bë anëtar i Partisë Bolshevike në vitin 1919. Kur Tito u rikthye në shtëpi në vitin 1920, Austro-Hungaria nuk ekzistonte më, ndërsa Kroacia ishte bërë pjesë e Mbretërisë së sapothemeluar të Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve (emri "Jugosllavi" u miratua zyrtarisht në vitin 1929).

Por ideologjia shtetërore e unitetit jugosllav, u sfidua shumë shpejt nga konfliktet kombëtare, veçanërisht midis serbëve, të cilët favorizonin centralizmin dhe dominonin në qeveri dhe ushtri, dhe kroatëve, të cilët favorizonin federalizmin ose krijimin e një shteti të veçantë kroat.

Partia Komuniste e Jugosllavisë, e krijuar në vitin 1919, tërhoqi fillimisht një numër të madh ndjekësish. Por ajo ishte më shumë revolucionare në retorikë sesa në veprim. Gjithsesi u shpall e jashtëligjshme në vitin 1921. Partia nuk i kishte përgatitur kuadrot për një luftë të fshehtë, dhe shumica e aktiviteteve të saj u pezulluan.

As Tito nuk ishte në atë kohë një militant i zjarrtë. Por ai u bë i tillë gradualisht, dhe në vitin 1927 u emërua sekretar i komitetit të rëndësishëm të partisë komuniste në Zagreb. Në atë kohë ra në sy duke treguar iniciativë dhe shkathtësi. Tito iu kundërvu përplasjeve midis fraksioneve brenda partisë, dhe ishte krenar dhe sfidues gjatë marrjes në pyetje në polici, gjyqit



dhe më shumë se 5 viteve burgim për veprimtari partiakë antiligjore.

Por persekutimi i qeverisë ndaj komunistëve favorizoi në mënyrë indirekte radikalët. Partia Komuniste nuk kishte zgjidhje tjetër, veçse të përqendrohej në veprimtarinë ilegale. Të njëjtin efekt pati edhe "diktatura e mbretit Aleksandër". Në vitin 1929 mbreti pezulloi qeverisjen parlamentare, vendosi regjimin e tij personal dhe e forcoi centralizmin serb. Pakënaqësia kombëtare, sidomos midis kroatëve u rrit, dhe u bë e qartë se Partia Komuniste nuk mund të qëndronte indiferente. Duke mos pasur parasysh ngjashmëritë e shumta etnike, gjuhësore dhe kulturore midis sllavëve të jugut dhe aspiratave të tyre të fuqishme të shekullit XIX drejt një shteti të përbashkët, udhëheqja komuniste ndërkombëtare e pa Jugosllavinë si një lloj mini-perandorie serbe të bazuar tek pushtimet ushtarake.

Prandaj, Kominterni kërkoi shpërbërjen e menjëhershme të "burgut të popujve", dhe tregoi më shumë simpati për radikalët jugosllavë, sesa për të moderuarit. Kërkesa për të ndarë Jugosllavinë në shtete më të vogla shkoi më tej sesa donin edhe shumica e radikalëve. Por të bindur ndaj Kominternit, komunistët jugosllavë e përfshinë atë në programin e tyre.

Gjithsesi në mesin e viteve 1930, Kominterni filloi ta perceptonte Jugosllavinë ndryshe, pra si një pengesë ndaj fashizmit dhe nazizmit (si Musolini ashtu edhe Hitleri donin të shkatërronin vendin). Ndërkohë, Partia Komuniste e Jugosllavisë e kishte gjithnjë e më problem mbrojtjen

e separatizmit, pasi partitë separatiste ishin kryesisht të krahut të djathtë, klerikale, profashiste antikomuniste.

Kominterni e emëroi Titon sekretar të përgjithshëm të Partisë Komuniste të Jugosllavisë në vitin 1937. Nga vitet 1944-1945, kur komunistët erdhën në pushtet në Jugosllavi, dhe deri në vdekjen e tij, Tito ishte për pjesën më të madhe të kohës kryetar i partisë, Marshall i Jugosllavisë, kryetar i qeverisë, komandant i përgjithshëm dhe president i vendit.

Ai ishte një politikan me përvojë që i kishte mbijetuar spastrimeve (dhe sipas disa rrëfimeve mori pjesë në to), dhe ishte shumë më i moshuar sesa shumica e bashkëpunëtorëve të tij më të afërt, të cilët e quanin "Stari" (Plaku). Edhe pse nuk ishte një nacionalist kroat, siç e portretizojnë sot shumë serbë, ai nuk ndante ndjenjën e fortë të komunistëve të rinj për të qenë jugosllav.

Për Titon, Jugosllavia mbeti kryesisht një ide politike, një taktikë për marrjen revolucionare të pushtetit. Uest e portretizon Titon si një diktator të moderuar dhe të butë. Dhe në krahasim me disa diktatorë të shekullit XX-të, kjo është padyshim e vërtetë.

Po ashtu ai e sheh Titon si një autokrat ngurrues, që kundërshtoi demokracinë dhe përpjekjet për liberalizim, pasi ato do të çlironin pasionet nacionaliste, dhe do rrezikonin unitetin e vendit. Megjithatë, vendi u shpërbë përfundimisht në një luftë të përgjakshme civile. Dhe kjo shpërbërje nuk ishte aq e papritur sa sugjerohet shpesh. Gjatë viteve 1980, shtetarët dhe diplomatët perëndimorë, shprehën besimin e vazhdueshëm mbi të ardhmen

dhe unitetin e Jugosllavisë. Ata nuk ishin naivë, por menduan se ishte më mirë të fshihnin frikën e tyre, pasi një diskutim i hapur i shpërbërjes së ngadaltë të Jugosllavisë mund ta kishte përshtetur atë.

Në atë kohë, shumë zyrtarë në Perëndim filluan të vërenin tendencat e fuqishme separatiste midis kroatëve dhe pakicës shqiptare, si dhe dobësinë e qeverisë qendrore në Beograd, ku shteti dhe partia drejtohehin nga presidenca kolektive.

Për më tepër, larg nga të qenit një unifikues i madh, Tito ndoqi shumë politika që e gërryenin unitetin. Në një mënyrë të thjeshtuar marksiste-leniniste, Tito e shihte nacionalizmin si "ideologji borgjeze" dhe konfliktet kombëtare si të shkaktuara nga "kapitalizmi".

Prandaj pas luftës, me mposhtjen e "borgjezisë", ai bëri shumë pak për të luftuar nacionalizmin dhe për të kultivuar unitetin. Ndërsa u krijua një program i përbashkët shkollor jugosllav, shkëmbimet kulturore midis 6 republikave të Jugosllavisë nuk ishin intensive dhe me kalimin e kohës u bënë të rralla.

Nuk u krijua asnjë universitet për të gjitha kombësitë, dhe nuk pati ndonjë politikë për nxitjen e studentëve që të studionin jashtë republikave të tyre. Ishte diçka shumë e rrallë që një profesor kroat të jepte mësim në Beograd, apo një serb në Zagreb. Edhe kur media mbrojti idetë pan-jugosllave, ky ishte një përjashtim nga rregulli.

Për të zgjidhur konfliktet e saj kombëtare, dhe për të kapërcyer historinë e saj të trishtë, Jugosllavia do të duhej të ishte e jashtëzakonshme. Ajo kishte nevojë për një ekonomi dinamike dhe për institucione politike moderne.

"Gjenialiteti" politik i Titos kishte të bënte pengimin dhe eliminimin e liderëve krijues dhe reformistë, qoftë brenda partisë komuniste, qoftë jashtë saj. Atë që Perëndimi e quajti "Titizëm", rezultoi të ishte asgjë më shumë se sa aftësia e Titos për të shmangur momentin e së vërtetës.

Talenti i tij ishte për moszgjidhjen e problemeve ishte pjesërisht produktiv, por me kushtin që ai të ishte në qendër të federatës policentrike jugosllave dhe që Perëndimi t'i jepte kredi të shumta. Kësaj Tito nuk ia pas asgjë të qëndrueshme. Në fund nuk mbijetoi as sistemi i tij vetëm-menaxhimit të punëtorëve, as politika e jashtme e mosangazhimit, dhe as vetë Jugosllavia.

Marrë me shkurtime nga "Foreign Affairs" – Bota.al



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Teuta triumfon ndaj Rahovecit



**DURRËS, 26 JANAR** - Teuta ka shënuar fitore shumë të rëndësishme, duke mundur Rahovecin me rezultat 83:80 (23:17, 22:23, 24:15, 14:25), në xhiron e nëntë të Ligës Unike. Pas një fillimi të barabartë, vendasit shkëputen duke krijuar epërsi prej tetë pikësh 19:11, ndërsa çerekun e parë e fitojnë 23:17. Vreshtarët e fillojnë furishëm periudhën e dytë, duke shkrië epërsinë dhe

e kthyen atë në favor të tyre 30:31, e më pas zhvillohet lojë e barabartë, megjithatë durrësakët e përfunduan pjesën e parë në të mirë të tyre 45:40. Dallimi i madh u bë në periodën e tretë, ku basketbollistët e Teutës ishin bindshëm më të mirë, për të thelluar epërsinë, ku më e larta ishte 14 pikë, 69:55, sa ishte rezultati në semafor pas 30 minutash. Në dhjetë minutat e fundit ndodhi

e kundërta, ku kësaj radhe rahovecasit tentuan të bëjnë përmbysjen e madhe, megjithatë, arritën të zvogëlojnë shifrat në vetëm tri pikë, 83:80, sa përfundoi ndeshja. Te Teuta u dallua Tamas Bruce me 20 pikë e 15 kërcime, kurse te Rahoveci u dallua Milik Yarbrough me 35 pikë e tetë kërcime. Teuta ka pesë fitore dhe katër humbje, ndërsa Rahoveci ka tri fitore e gjashtë humbje.

## SHKURT

### Muriqi, afër kalimit te Mallorca

Sulmuesi Vedat Muriqi është gjithnjë e më afër transferimit te Mallorca në La Liga. Klubi spanjoll ka hedhur në tavolinë një huazim të rëndë prej 300 mijë eurosh deri në fund të sezonit, me të drejtë blerjeje përfundimtare të bomberit të Kosovës për 13 milionë euro. Mbyllja e operacionit është një hap larg. Lazio është gati ta japë dritën jeshile, edhe sepse Mallorca ka garantuar pagesën e të gjithë pagës së sulmuesit "dardan" nga tani deri në qershor.

### FC Phoenix-Banjë përforcohet me Muratin

FC Phoenix-Banjë është përforcuar edhe me një futbollist cilësor. Fjala është për sulmuesin Almedin Murati i cili ka bërë karrierë edhe në skuadrën e Dritës dhe Vëllaznimit. "FC Phoenix-Banjë. Sot FC Phoenix ka arritur marrëveshje me sulmuesin Almedin Murati. Murati është sulmues i dëshmuar në futbollin e Kosovës. Së fundmi ka qenë pjesë e KF Arbëria, por më parë ka luajtur edhe për KF Vëllaznimi dhe FC Drita. FC Phoenix i dëshiron mirëseardhje Almedinit dhe shumë suksese me ekipin tonë", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Banja.

### Southamptoni me ofertë të madhe për Brojën

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Broja, po shkëlqen në Premierë Ligë me fanellën e Southamptonit. Klubi anglez që e ka Brojën në formë huazimi është i interesuar ta blejë përfundimisht kartonin e tij. Raportohet se Southamptoni është gati të paguajë 30 milionë euro për sulmuesin shqiptar. E ardhmja e futbollistit kuqez i është në duart e skuadrës së Chelseat.

### Voca vazhdon karrierën në Itali

Mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës, Idriz Voca, është bërë me skuadër të re. Futbollisti i Kosovës ka vendosur që ta vazhdojë karrierën në futbollin italian. Gjegjesisht, 24-vjeçari i është bashkuar Cosenzas që garon në Serinë B. Voca ka qenë pa klub që prej verës së vitit të kaluar kur u largua nga Ankaragucu. Gjithashtu, ai ishte në prova te St Galleni, por tani karrierën do ta vazhdojë në Itali.

### Ardi Krasniqi rikthehet në Istog

Klubi i Ligës së Parë, Istogu, ka njoftuar se e ka rikthyer futbollistin Ardi Krasniqi. "Football Club Istogu me kënaqësi njofton të gjithë opinionin sportiv, dashamirët dhe tifozët e Istogut, që klubi ka përmbyllur me sukses marrëveshjen me mesfushorin defensivë Ardi Krasniqi. Marrëveshja me Ardi Krasniqin është arritur deri më 30 qershor 2022, me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër. 22-vjeçari pas 18 muajve rikthehet prapë në Istog. Në sezonin e fundit ishte pjesë e klubit Dardania", thuhet në njoftimin e FC Istogu. Krasniqi luan në pozitën e mesfushorit defensivë, por di mjaft mirë të përshtatet edhe në vijën e mbrojtjes.

## Akademia Olimpikë e KOK-ut bëhet anëtare e Akademisë Olimpikë Ndërkombëtare

**PRISHTINË, 26 JANAR** - Akademia Olimpikë e Komitetit Olimpik të Kosovës është bërë anëtare me të drejta të plotë në Akademinë Olimpikë Ndërkombëtare (IOA). KOK-u kishte aplikuar për anëtarësim muajin e kaluar, ndërsa konfirmimi zyrtar ka ardhur me përfshirjen e Kosovës në

mesin e të gjitha akademive të tjera olimpikë kombëtare. Është ky një hap tjetër drejt zhvillimit të mëtutjeshëm të Akademisë Olimpikë e cila u themelua nga KOK-u vetëm muaj më parë. Qëllimi i Akademisë Olimpikë të Kosovës është t'i promovojë vlerat olimpikë dhe shpirtin

olimpik në Kosovë, me fokus të veçantë edukimin e stafit profesional në fushën e sportit. Me këtë rast, javën e kaluar u organizua kursi teknik për trajnerët dhe gjyqtarët e mundjes, ndërsa që nga kjo javë do të nisë edicioni i tretë i Kursit të Avancuar për Menaxhimin Sportiv (ASMC).



## Dy vjet nga vdekja tragjike e legendës së basketbollit Kobe Bryant

LOS ANXHELOS, 26 JANAR - Saktësisht në këtë ditë të 26 janarit 2020, dy vjet më parë, ka vdekur Kobe Bryant, një nga basketbollistët më të mëdhenj në histori. Basketbollisti legjendar humbi jetën në një aksident me helikopter, ku me të ishte edhe

vajza e tij 13-vjeçare Xijana, si dhe shtatë persona të tjerë. Helikopteri i Kobe Bryantit u rrëzua pranë Calabasas, kur goditi një kodër për shkak të dukshmërisë së dobët dhe kushteve të vështira të fluturimit. Bryant, i mbiquajtur "Black

Mamba", ka lindur në vitin 1978 dhe nga viti 1996 deri më 2016 ka luajtur për Los Angeles Lakersin, me të cilin ka fituar pesë tituj të NBA-s. Ai e ka kaluar të gjithë karrierën e tij me Lakersin, i cili kishte veshur fanellat 8 dhe 24 që kishte veshur Bryantit. Ai ishte dy

herë lojtari më i mirë në finalët e NBA League, një herë MVP i sezonit të rregullt dhe 18 herë ka marrë pjesë në lojën e yjeve, ka fituar garën e dunk-ut dhe ishte golashënuesi më i mirë i ligës në dy raste. Me kombëtaren amerikane ai ka fituar dy



medalje të arta në Lojërat Olimpikë në Pekin më 2008 dhe Londër më 2012.

## Bajrami, pasardhës i Insignes në Napoli

NAPOLI, 26 JANAR - Nedim Bajrami po kalon një moment fantastik. Ai është kthyer në një nga lojtarët më të përfolur në Serinë A. Prej kohësh flitet për një interesim nga ana e Sassuolos, Torinos, Interit dhe Lazios, ndërsa së fundmi në skenë ka dalë edhe Napoli. Sipas "La Gazzetta dello Sport", Napoli po vlerëson seriozisht këtë opsion pasi në sytë e drejtuesve Bajrami shihet si lojtari ideal për ta zëvendësuar Insignen i cili në fund të sezonit do të nisë një aventurë të re te Toronto. Bajrami tek Empoli aktivizohet pas dy sulmuesve, ndërsa deri më tani ka shënuar 6 gola në Serinë A dhe ka dhuruar 8 asistime. Fantazisti shqiptar u transferua te Empoli më 2019 për 800 mijë euro, ndërsa tashmë kushton 10 milionë euro. Presidenti Corsi është i vetëdijshëm që ka në dispozicion një "xhevahir" që mund t'i mbushë arkat e klubit dhe po



shqyrton me qetësi të gjithë ofertat që vijnë në drejtim të Bajramit. Vështirë të mendosh se mund ta mbajë më gjatë. Në fund

të sezonit, futbollisti shqiptar pritet të ndryshojë skuadër pasi për të interesohen klubet më të mëdha në Serinë A.

## Lakersat fitojnë duelin me Brooklynin

BROOKLYN, 26 JANAR - Ekipi i Lakersave fitoi sot ndeshjen e madhe të NBA-së ndaj Brooklynit me rezultatin 106-96. Fitore e rëndësishme kjo për kalifornianët ndaj një skuadre rivale, por lajmi më i mirë është rikthimi në fushë i Davis (8 pikë në 25 minuta). Më i miri për Lakersat ishte James me 33 pikë, duke i bërë të pavlefshme 33 pikët, 12 reboundet e 11 asistimet e Hardenit për Netsin. Pa



probleme fiton ekipi i Golden States, që mposhti me rezultat 130-92 Dallasin, sfidë ku 7 lojtarë të Warriorsit realizuan mbi 10 pikë (Kuminga 22 pikë më i miri). Fitore

në sekondat e fundit arriti Clippers, që mundi 116-115 Washingtonin, me dyshen Coffey-Kennard protagonistë që, së bashku, realizuan 54 pikë.

### REZULTATET

Detroit - Denver	105-110
Philadelphia - New Orleans	117-107
Toronto - Charlotte	125-113
Washington - Clippers	115-116
Boston - Sacramento	128-75
Brooklyn - Lakers	96-106
Houston - San Antonio	104-134
Golden State - Dallas	130-92
Portland - Minnesota	107-109

### SHKURT

#### Xhaka mund ta përforcojë Romën

Trajneri i Romës, Jose Mourinho, nuk heq dorë nga lojtari shqiptar dhe vazhdon e këmbëngul për transferimin e tij në Serinë A. Granit Xhaka u përfol shumë në merkaton e verës së kaluar për një kalim te verdhekuqtë, përpjekje këto që nuk arritën të finalizoheshin, pasi mesfushori i Arsenalit rinovoi kontratën me "topçinjtë". Mungojnë dhe pak ditë nga mbyllja e merkatos dimërore dhe në këtë mënyrë, siç raportojnë mediet italiane, Tiago Pinto po punon për afrimin e një mesfushori dhe Xhaka mund të jetë "dhurata" e fundit për Mourinhon. Transferimi i Arthur në Londër mbetet çelësi i zhblokimit të tratativës në mënyrë që Xhaka të vihet nën urdhrat e Jose Mourinhos.

#### Kahn konfirmon largimin e Sules

Mbrojtësi Niklas Sule do të largohet përfundimisht nga skuadra e Bayern Munchenit. Lajmin e ka dhënë Oliver Kahn, drejtor i përgjithshëm i klubit bavarez, duke theksuar se qendërmbrojtësi nuk e pranoi ofertën e rinovimit. "Negociatat ishin të gjata. Ne i bëmë një ofertë që Sule nuk e pranoi. U bë një ofertë shumë e mirë, por ne duhet t'i përmbushim disa kufij financiarë. E dimë që Niklas dëshiron të largohet në fund të sezonit", ka deklaruar Kahn. E ardhmja e reprezentuesit të Gjermanisë do të jetë Barcelona ose Chelsea.

#### Perini infektohet me Covid

Skuadra e Juventusit ka njoftuar se Mattia Perini ka rezultuar pozitiv me koronavirus. "Juventusit njofton se futbollisti Mattia Perin ka dalë pozitiv për Covid-19. Ai tashmë është në përcjellje të protokollit dhe po i respekton rregullat", thuhet në njoftimin e klubit torinez. Perini është portieri i dytë i Juventusit dhe ka luajtur në gjashtë ndeshje në të gjitha garat këtë edicion. Kontrata e tij skadon në verë dhe Juventusit ende është i hapur për vazhdimin e kontratës së tij.

#### Edhe Lingard do të largohet nga Unitedi

Pavarësisht se Jesse Lingard nuk po kalon një moment të mirë te Manchester Unitedi, mbetet një nga lojtarët më të kërkuar në merkato. Kontrata e mesfushorit përfundon në qershor të këtij viti. Kjo situatë bën të mundur largimin përfundimtar të tij nga "djajtë e kuq". Në gjurmët e tij, përveç Newcastle, West Hamit dhe disa klubeve spanjolle, është futur edhe Nice e Christophe Galtier. Klubi francez që aktualisht renditet i dyti në kampionat kërkon të përforcohet për ta siguruar pjesëmarrjen në Ligën e Kampionëve edhe pse mundësitë e tyre financiare nuk mund ta përballojnë një lojtar si Lingard.

## Kessie arrin marrëveshje me Barcelonën

Franck Kessie duket se ka ndarë mendjen për të ardhmen. Mesfushori e ka bërë zgjedhjen e tij për t'u larguar nga kuqezinjtë. Lojtari nga Bregu i

Fildishtë ka zgjedhur të mos e vazhdojë më karrierën në Itali, por në një kampionat tjetër po aq të fortë. Nga Spanja vijnë lajme të sigurta se Kessie ka

gjetur një akord paraprak me Barcelonën dhe do të jetë gati për aventurën e re gjatë verës së ardhshme. Sipas tyre, Kessie është dëshirë edhe e teknikut

spanjoll Xavi Hernandez që mund ta ndihmonte shumë në mesfushë. Megjithatë, detaje të tjera nga kjo transfertë nuk bëhen të ditura. Edhe në Itali

portale të njohura shkruajnë se lojtari ka një pajtim verbal me skuadrën katalanase dhe pritet që në fillimin e edicionit të ri çdo gjë të zyrtarizohet.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, Udhëzimit administrativ nr. 02/2018 për Qendrat Burimore, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe kërkesës së Qendrës Burimore, Departamenti i arsimit parauniversitar, shpall;

### KONKURS

#### Për vendin e lirë të punës në Qendrën Burimore për mësim dhe këshillim "Xheladin Deda" në Pejë

Nr.	Pozita	vendi i lirë/zëvendësim	Nr. i pozitave
1	Psikolog/e në QB "Xheladin Deda" në Pejë	vend i lirë	1

#### III. Punët dhe detyrat e psikologut/es

- Identifikon nxënësit të cilëve u nevojitet ndihma dhe trajtimi adekuat psikologjik;
- Përpilon teste të bazuara për diagnostikimin e vështirësive në mësimdhënie;
- Mban lidhje me ekipet profesionale të qendrës burimore;
- Këshillon nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë në mësim, punë vazhduese, këshillon zgjedhjen e profesionit ose të cilët kanë nevojë për këshilla për të tejkaluar problemet personale;
- Kontribuon në lehtësimin e procesit të të nxënimit dhe promovon zhvillimin kognitiv, emocional, social dhe personal të nxënësve;
- Ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë;
- Vlerëson dhe interpreton çështjet që kanë të bëjnë me procesin e të nxënimit dhe zhvillimit kognitiv, emocional, social dhe personal të nxënësve;
- Asiston dhe vlerëson nevojat e nxënësve, bashkëpunon me profesionist të tjerë dhe zbaton vlerësimet e përshtatshme (të besueshme dhe valide);
- Psikologu ka për detyrë të punojë drejtpërdrejtë me nxënësit.

#### 1. Përgatitja shkollore e psikologut/es

- Niveli master në degën e Psikologjisë - drejtimi Psikologji shkollore dhe këshillim të Fakultetit Filozofik.

#### Kushtet e konkursit

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, paragrafi 4.2 i nenit 2 të UA 34/2014 Funksionimi i Shërbimit Pedagogjik-Psikologjik në Shkollë.

Sqarim shtesë: - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente

- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHTI.
  - Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit. Kandidatët që aplikojnë duhet të jenë banorë të Republikës së Kosovës.
- Perioda provuese e punës është 1 (një) vit.

#### Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Qendër Burimore).

Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).

Diploma e kualifikimit (ose certifikatë) certifikata në vend të diplomës duhet të jetë e noterizuar.

Dëshmi që nuk është nën hetime.

Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Qendrën Burimore përkatëse ku konkurrojnë. Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Na osnovu člana 8. stav 1. i 2. Zakona o radu br. 03/L-212, (Službeni glasnik Republike Kosovo, br. 90/2010), LZakon o pred univerzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo br. 04 / L-032, Administrativno uputstvo br. 02/2018 o Resursnim centrima, Administrativno uputstvo br. 07/2017, o regulisanju procedure konkurisanja u javnom sektoru i zahtevima Resursnih centara, Departament za pred univerzitetsko obrazovanje objavljuje;

### KONKURS

#### Za slobodna radna mesta u Resursnim centrima za nastavu i savetovanje "Xheladin Deda" u Peći

Br.	Položaj:	slobodno radno mesto/zamena	Br. pozicija
1	Psihologija/ca u RC "Xheladin Deda" u Peći	slobodno radno mesto	1

#### III. Zadaci i obaveze psihologa

- Identifikuje učenike kojima je potrebna odgovarajuća psihološka pomoć i lečenje;
- Sastavlja testove zasnovane na dijagnosticanju poteškoća u nastavi;
- Održava vezu sa profesionalnim timovima resursnog centra;
- Savetuje učenike kojima je potrebna pomoć u učenju, kontinuiranom radu, savetuje izbor profesije ili koji imaju potrebe za savet za prevazilaženje ličnih problema;
- Doprinosi u olakšavanju procesa učenja i podstiče kognitivni, emotivni, socijalni i lični razvoj učenika;
- Pruža pomoć u prevazilaženju teškoća psihološke prirode kod svim akterima u školi;
- Ocenjuje i interpretira pitanja vezana za proces učenja i kognitivni, emocionalni, socijalni i lični razvoj učenika.
- Pomaže i procenjuje potrebe učenika, saraduje sa drugim profesionalcima i sprovodi odgovarajuće (pouz dane i valide) procene.
- Psiholog ima obavezu da radi direktno sa učenicima.

#### 1. Školska sprema psihologa

- Nivo master Psihologije - smer Školska psihologija i savetovanje Filozofski fakultet.

#### Uslovi konkursa

Izbor kandidata se vrši na osnovu kriterijume Zakona koji regulišu oblast obrazovanja: LUakon o preduverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, br. 04/L-032, stav 4.2 i član 2 AU 34/2014 Funksionisanje službe Pedagoga-Psihologa u škol .

**Dodatno obrazloženje:** -Informacije prikazane u aplikaciji smatraju se validnim samo u koliko budu potkrepljeni dokazom

- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju dostaviti da je izvršena nostrifikacija dokumenta i MONTI-a.

- Na intervju će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju kriterije konkursa.

Kandidati koji apliciraju moraju biti stanovnici Republike Kosovo.

Probni period rada je 1 (jedna) godina.

#### Rok i način apliciranja

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od objave konkursa u medijima javnog informisanja.

Popunjena formulara za aplikaciju (može se dobiti u Resursne Centre).

Lični dokument (lična karta ili pasoš).

Diploma kvalifikacije (ili certifikat) certifikat umesto diplome mora biti noterizovan;

Dokaz da nije pod istragu

Kandidati, dokumenta moraju dostaviti u relevantni Resursni centar u kojem konkuriraju. Ne kompletirane aplikacije neće se uzeti na razmatranje.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se "Burimi" SH.P.K. Fehmi Latifi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810257411 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Burimi" D.O.O. Fehmi Latifi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810257411 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the "Burimi" L.L.C. Fehmi Latifi, has come to the decision to quit its business: 810257411 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Fidan Latifi Prishtinë, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës fillore "Gjergj Fishta" Prishtinë.

► Mon Shala Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F "Shaban Gola" Lipovec KK Gjakovë.

► Diandra Zhuri Gjakovë, shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Genc Grezda B.I. Power Supply Solution" N.T.SH. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 810321042.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtime i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

